



Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inxhinjere Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
Nr. Prot. 233/2025	
Org. Jednica 01RK	Prot. No.
Nr. I tagjeve	Data: 28.05.2025
Nr. Stranica	Date:
Nr. Pages	
PRISHTINË / A No.1	

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

I LIDHUR NDËRMJET

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

**FAKULTETI I INXHINIERISË NDËRTIMORE DHE INFRASTRUKTURËS –
KOLEGJI UBT**

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012 Për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, Statutin dhe Aktet e brendshme të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, Statutin e Kolegjit UBT- Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës, si dhe duke u bazuar në parimin e bashkëpunimit institucional për ngritjen e cilësisë së arsimit dhe avancimin e profesionit të inxhinierisë ndërtimore dhe infrastrukturës në Republikën e Kosovës, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) dhe Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës – Kolegji (tani e tutje palët) të përfaqësuara nga:

Kryetar: **Z. Arsim Rapuca**, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)

Adresa: Kompleksi Rilindja, Kontejneri Nr. 3, Kati 2, 10000 Prishtinë

dhe

Prof. Dr. **Visar Krelani**, Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës – Kolegji UBT

Adresa: Lagjja Kalabria, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Duke njohur të drejtat, detyrimet, veprimtarin dhe aktivitetet të cilin e ushtrojnë brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe më gjerë.

Duke njohur karakterin global të zhvillimeve institucionale dhe akademike;

Duke njohur domosdoshmërinë për avancimin institucional dhe akademik;

Të vetëdijshëm për rëndësinë që ka avancimi institucional, akademik dhe shkencor për brezat e tashëm dhe të ardhëshëm në shkallë vendi;

Të vetëdijshëm se vetëm përmes bashkëpunimi, koordinimit etj., mund të arrihen rezultatet bashkohore dhe nivel i lartë i ngritjes akademike dhe shkencore;

Udhëhequr nga normat dhe parimet e pranuarra nacionale dhe ndërkombëtare;

Të bindur për një bashkëpunim reciprok, miqësor dhe afatgjatë si një faktor qenësor për zhvillim të qëndrueshme palët:

Lidhin këtë Marrëveshje Mirëkuptimi e përshkruar në nene, paragrafet dhe nënparagrafet si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo marrëveshje mirëkuptimi ka për qëllim të përcaktoj të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fushën e bashkëpunimit të palëve, përfshirë ngritjen e cilësisë së arsimit në fushën e inxhinierisë ndërtimore; forcimin e lidhjes mes arsimit dhe profesionit; mbështetjen e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të studentëve të sapodiplomuar,

praktikantëve dhe inxhinierëve të licencuar; dhe promovimin e vlerave profesionale, etike dhe teknike në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 2

Fushë e zbatimi

2. Dispozitat e kësaj marrëveshje mirëkuptimi zbatohen vetem për palët nënshkruese të kësaj marrëveshje

Neni 3

Koordinimi

3. Palët do të caktojnë nga një koordinator të autorizuar, të cilët do të jenë përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Koordinatorët do të koordinojnë aktivitetet e përbashkëta, do të përcjellin zbatimin dhe do të raportojnë rregullisht te palët përkatëse.

Neni 4

Fusha e bashkëpunimit

4. Palët pajtohen të bashkëpunojnë në:
 - 4.1. Rishikimin dhe avancimin e programeve studimore në lëmin e inxhinierisë së ndërtimit dhe infrastrukturës;
 - 4.2. Zhvillimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta hulumtuese (aty ku ka mundësi) në shkallë vendi;
 - 4.3. Koordinimin dhe pjesëmarrjen e përbashkët (aty ku ka mundësi) në projektet e financuara nga fonde të bashkimit evropian për arsimin e lartë, konkretisht në fushen e inxhinierisë;
 - 4.4. Koordinimin dhe pjesëmarrjen aktive në ndërtimin e infrastrukturës (aty ku ka mundësi) për përgatitjen e inxhinierëve të ndërtimtarisë dhe infrastrukturës për fazën e licencimit;
 - 4.5. Koordinimi, Bashkëpunimi dhe Organizimin i forumeve, debateve, seminareve, konferencave dhe trajnimeve për inxhinierin ndërtimore dhe infrastukturën;
 - 4.6. Aktivitete akademike dhe profesionale të përbashkëta-përfshirë ligjërata publike, seminare, punëtori dhe trajnime me pjesëmarrjen e stafit akademik dhe ekspertëve profesionalë nga të dy institucionet;
 - 4.7. Edukimi i vazhdueshëm profesional-përkrahje të ndërsjellë për organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve për edukim të vazhdueshëm profesional për studentët e sapodiplomuar, praktikantët dhe inxhinierët e licencuar;
 - 4.8. Shfrytëzimi i hapësirave të Fakultetit-Fakulteti angazhohet të ofrojë, pa kosto, një nga sallat me hapësira më të mëdha apo hapësirat e përshtatshme për realizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve profesionale të organizuara nga OIRK, organizimin si dita e inxhinierëve, këto në përputhje me kapacitetet dhe agjendën e Fakultetit;
 - 4.9. Zhvillimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i praktikës profesionale për studentët e sapodiplomuar - Bashkëpunim për të siguruar kushte cilësore dhe mentorim profesional nga anëtarë të OIRK për realizimin e praktikës pas diplomimit;
 - 4.10. Kontribut në zhvillimin e kurrikulave akademike - përfshirje të OIRK në proceset e shqyrtimit të kurrikulave dhe standardeve akademike, me synim përputhshmërinë me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet teknike bashkëkohore;

- 4.11. Mbështetje për hulumtime dhe projekte të përbashkëta shkencore-përfshirë publikime, aplikime në fonde kërkimore dhe pjesëmarrje në konferenca e ngjarje shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- 4.12. Angazhimi i studentëve aktivë dhe studentëve të sapodiplomuar në administratën e OIRK - Fakulteti do të përkrahë identifikimin dhe përzgjedhjen e studentëve për angazhim në punë praktike apo vullnetare në administratën e Odës, me qëllim ofrimin e përvojës praktike institucionale, ngritjes së aftësive profesionale, pa implikime financiare.

Neni 5

Përkrahja profesionale dhe pjesmarrja aktive në hartimin dhe rishikimin e kuadrit ligjor në fushën e ndërtimit

- 5.1. Palët pajtohen që, sipas nevojës dhe kapaciteteve të tyre, të ofrojnë përkrahje të ndërsjellë në çështje që lidhen me zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit, rregulloreve dhe standardeve profesionale në fushën e ndërtimit.
- 5.2. Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës do të kontribuojë me ekspertizën e stafit akademik në proceset e shqyrtimit profesional, analizës së implikimeve teknike të propozimeve ligjore dhe përgatitjes së opinionit akademik në fushat përkatëse, sipas kërkesës së OIRK.
- 5.3. Ndërsa OIRK do të përkrahë Fakultetin e Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës në adresimin e sfidave praktike që lidhen me harmonizimin e mësimdhënies dhe kërkesave të tregut, si dhe në ofrimin e informacioneve teknike dhe praktike nga fusha për përmirësimin e politikave arsimore dhe profesionale.
- 5.4. Ky bashkëpunim synon të ndihmojë në: përmirësimin e kuadrit ligjor dhe profesional për ndërtimin në Kosovë; fuqizimin e rolit të institucioneve akademike në proceset vendimmarrëse në fushën e inxhinierisë dhe ngritjen e standardeve teknike e etike në ushtrimin e profesionit.

Neni 6

Kohëzgjatja, rishikimi, tërheqja

- 6.1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të jetë e vlefshme për një periudhë tre (3) vjeçare. Marrëveshja mund të rishikohet, plotësohet dhe ndryshohet me marrëveshje të palëve nënshkruese.
- 6.2. Palet bien dakort se çdo gjë që mbulohet nga kjo marrëveshje mirëkuptimi, interpretim, menaxhim, zbatim, etj., do të zgjidhet me dialog, marrëveshje reciproke, të ndërsjellë dhe përmes strukturave më të larta të palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje;
- 6.3. Palët bien dakord që kjo marrëveshje mirëkuptimi është shprehje e vullnetit të mirë për avancim, zhvillim, bashkëpunim dhe koordinim në fushat e bashkëpunimit dhe nuk paraqet as një formë imponimi;
- 6.4. Palët bien dakort që çdo njëri nga ta mund të tërhiqet nga kjo marrëveshje mirëkuptimi, por që në një periudhë 60 ditore para se të tërhiqet nga kjo marrëveshje mirëkuptimi të njoftoj palët tjera;

- 6.5. Palët bien dakord të mos inicojnë dhe ndërmmarrin masa dhe të kryejnë çfardo aktiviteti në fushën e bashkëpunimit që do të sillte dëme për palën tjetër (do ta dëmtonte palen tjetër brenda kësaj marrëveshje mirëkuptimi);

Neni 7

Financimi

- 7.1. Palet bien dakort që kjo marrëveshje mirëkuptimi nuk ka implikime financiare (detyrime financiare);
- 7.2. Palet bien dakort që financimi i ndonjë aktivitetet të përbashkët mund të bëhet në pajtueshmëri dhe harmoni me aktet juridike të palëve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje;

Neni 8

Komunikimi dhe dokumenti

- 8.1. Palët në komunikimin e tyre bazohen në Ligjin Nr. 02/L-37 Për Përdorimin e Gjuhëve;
- 8.2. Marrëveshja e mirëkuptimit përgatitet në tre kopje autentike (origjinale) në dy gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës dhe në gjuhën Angleze dhe secila palë mbanë nga një version origjinal (autenitk) të memorandumit;

Neni 9

Dispozita Përfundimtare

9. Çdo çështje që nuk është e rregulluar shprehimisht me këtë marrëveshje do të trajtohet në frymën e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë. Marrëveshja do të zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin juridik të brendëshem të të dyja palëve.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshja e mirëkuptimit hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të palëve;

Ing.Dpl. Arsim Rapuca, Kryetar

OIRK

Nënshkrimi



Prishtinë, 28 Maj 2025

Prof. Dr. Visar Krelani, Dekan

INI-UBT

Nënshkrimi

